



245/2
Dt. 15.03.2022

REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 207/2 Prot.

Fier, më 11.03.2022

Lënda: Përfundime të verifikimit në vend të ligjshmërisë së akteve në Këshillin e Qarkut Fier.

KRYETAR I KËSHILLIT TË QARKUT FIER
FIER

❖ **HYRJE**

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier në datën 02.03.2022 verifikoi në vend ligjshmërinë e akteve në Këshillin e Qarkut Fier për periudhën dhjetor 2021, janar-shkurt 2022. Grupi i punës përbëhej nga Alma Gjonaj përgjegjëse e sektorit juridik dhe Dorjana Spaho specialiste e sektorit juridik.

❖ **BAZA LIGJORE**

Institucioni i Prefektit planifikoi dhe zhvilloi këtë veprimtari, bazuar në legjislacionin e mëposhtëm:

- Nenin 17 i Ligjit Nr. 107/2016 “ *Për Prefektin e Qarkut* ”;
- Ligjin Nr. 44/2015 “ *Kodi i Procedures Administrative i Republikës së Shqipërisë* ”;
- Ligjin Nr. 139/2015 “ *Për Vetëqeverisjen Vendore* ” (i ndryshuar).

❖ **METODOLOGJIA E KRYERJES SË VERIFIKIMIT TË AKTEVE**

Fillimisht, me shkresën Nr 207 Prot datë 22.02.2022 Prefekti i Qarkut Fier njoftoi Këshillin e Qarkut Fier për ushtrimin e detyrimit të tij ligjor. Me anë të kësaj shkrese u përcaktua periudha e akteve normative që do të verifikoheshin.

Në datën 02.03.2022 grupi i punës u paraqit në Këshillin e Qarkut Fier ku mori takim me specialisten e arkivë- protokollit Znj. Antonila Ndreko dhe Sekretarin e Këshillit të Qarkut Fier Z. Nebi Memushaj. Në këtë takim u bë i njohur qëllimi, plani dhe metoda e kontrollit. Kjo e fundit konsiston në analizimin e dokumentacionit që ndodhet në arkivë për mbledhjet e Këshillit të Qarkut.

❖ **OBJEKTI I KONTROLLIT**

- Verifikimi ka për objekt kontrollin në vend të akteve normative të Këshillit të Qarkut Fier për periudhën dhjetor 2021 dhe janar-shkurt 2022
- Librin e procesverbalit të mbajtjes së mbledhjeve të Këshillit të Qarkut.
- Zbatimin e rekomandive të lëna në kontrollin e mëparshëm.

❖ VERIFIKIMI I AKTEVE ME KARAKTER NORMATIV

Kompetenca e Prefektit për ushtrimin e verifikimit në vend të akteve me karakter normativ bazohet në Ligjin Nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, nenin 8 “Përgjegjësitë kryesore të Prefektit të Qarkut”, në pikën 2 të Nenit 16 “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, si dhe nenin 17 “Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve”.

Grupi i punës gjatë verifikimit konstatoi se:Këshilli i Qarkut Fier për periudhën dhjetor 2021 dhe janar-shkurt 2022 ka zhvilluar gjithësej 2 mbledhje.

- ✓ Mbledhja e datës 22.12.2021 në të cilën janë miratuar gjithësej 18 vendime nga të cilat 3 vendime me karakter normativ të verifikuara në përputhje me ligjin.

Vendimet me karakter normativ si më poshtë vijon :

- ✓ Vendimi Nr. 15 datë 22.12.2021 i Këshillit të Qarkut Fier “Për miratimin e tarifave për shërbimet publike publike që realizohen në Këshillin e Qarkut Fier”.
- ✓ Vendimi Nr.16 datë 22.12.2021 i Këshillit të Qarkut Fier “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Fier për vitin 2022”.
- ✓ Vendimi Nr.17 datë 22.12.2021 i Këshillit të Qarkut Fier “Për miratimin e Dokumentit Përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024” për Këshillin e Qarkut Fier”.

Thirrja për mbledhjen është bërë në datën 10.12.2022.

Në këtë mbledhje nuk ka vendime me karakter normativ të kthyer në kundërshtim me ligjin apo të dërguara në gjykatë.

- Mbledhja e datës 07.02.2022 në të cilën janë miratuar gjithësej 5 vendime nga të cilat vetëm 1 vendim me karakter normativ i verifikuar në përputhje me ligjin.
- ✓ Vendimi Nr. 2 datë 07.02.2022 i Këshillit të Qarkut Fier “Mbi miratimin e një shtese në buxhetin e Këshillit të Qarkut Fier nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2021”

Thirrja për mbledhjen është bërë në datën 26.01.2022.

Për këtë mbledhje nuk ka vendime me karakter normativ të kthyer në kundërshtim me ligjin apo të dërguara në gjykatë.

Struktura e vendimeve është në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 99. Vendimet me karakter normativ janë të shoqëruar nga projektvendimet si dhe relacionet përkatëse. Procesverbali i mbledhjes mbahet në libër të sekretuar të vullosur dhe protokolluar. Procesverbali është mbajtur në përputhje me Normat

Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë neni 18. Rezulton se nga ana e këshillit është miratuar procesverbali i mbledhjes në përputhje me Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” neni 16

- Nga verifikimi rezultoi se për këtë periudhën objekt kontrolli nuk ka akte normative të Këshillit të Qarkut Fier të padepozituara për verifikim ligjor.

Grupi i kontrollit mbajti në vend një Akt-Konstatimi me specialisten e arkivë protokollit Antonila Ndreko për aktet e verifikuara. Ky akt u mbajt në dy kopje një Këshilli i Qarkut Fier dhe një institucioni i Prefektit të Qarkut Fier.

❖ KONTROLLI I ZBATIMIT TË REKOMANDIVE TË LËNA

Përsa u përket rekomandimeve të lëna nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën Nr. 941/2 Prot datë 10.09.2021 në përfundim të verifikimit në vend të ligjshmërisë së akteve normative për periudhën qeshor-gusht 2021, rezulton se i është lënë vetëm një rekomandim si më poshtë vijon

• Rekomandimi i lënë:

“Duke filluar nga mbledhja në vazhdim të miratohet procesverbali i mbledhjes në përputhje me Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” neni 16”. Ky rekomandim është zbatuar.

Nga verifikimi i akteve në protokoll konstatojmë se për periudhën shtator-nëntor Këshilli i Qarkut Fier nuk është mbledhur. Mbledhja e fundit për vitin 2021 është mbledhja e datës 22.12.2021 ndërsa mbledhja përpara kësaj mban datën 12.07.2021. Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 76 pika 2 parashikohet se “Mbledhja e radhës së Këshillit të Qarkut bëhet jo më pak se një herë në tre muaj” Nga ana e Këshillit të Qarkut Fier nuk është zbatuar ky detyrim ligjor.

❖ PËRFUNDIM

Në përfundim të kontrollit të ushtruar grupi i punës arrin në përfundimin se :

- Për mbledhjet e Këshillit të Qarkut Fier për periudhën objekt kontrolli nuk ka akte normative të padepozituara për verifikim tek Prefekti i Qarkut.
- Nga ana e Këshillit të Qarkut Fier është zbatuar rekomandimi i lënë për miratimin e procesverbalit të mbledhjes në përputhje me Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” neni 16
- Është respektuar njoftimi për mbledhjen e Këshillit të Qarkut në zbatim ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 76 pika 6.
- Për muajin dhjetor 2021 dhe janar-shkurt 2022 nuk ka vendime me karakter normativ të kthyer në kundërshtim me ligjin apo të dërguara në gjykatë.

- Nga ana e Këshillit të Qarkut Fier nuk është zbatuar detyrimi ligjor lidhur me afatin e mbledhjes së radhës “jo më pak se një herë në tre muaj”

❖ **REKOMANDIM**

- Këshilli i Qarkut Fier duhet të mblidhet jo më pak se njëherë në tre muaj në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeversijen vendore” (i ndryshuar) neni 76 pika 2.

Grupi i Punës

Alma GJONAJ 

Dorjana SPAHO 

Konfirmoi: A.VELO Sek.Përgjithshëm 

PREFEKTI
Lefter Shehaj



